



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDË
Përkthim C-A (1)

Ngarkesa: 6 kredite (= 60 orë mësimore); 1.5 Kredite Leksion(= 15 orë mësimore); 4.5 Kredite seminar (= 45 orë mësimore)

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave, ‘‘Përkthim Teknik-letrar dhe Interpretim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të trajtojë përkthimin si proces dhe produkt në ndërthurje me analizën e teksteve në nivel mikro dhe makro, duke i pajisur studentët me aftësinë për të përkthyer me ekuivalencë funksionale. Të zhvillojë aftësitë për të përkthyer tekste të ndryshme funksionale, me fokus në stilin e medias së shkruar dhe të folur, duke ndërlidhur njohuritë gjuhësore me kontekstin kulturor. Të forcojë qasjen shumëdisiplinore dhe ndërdisiplinore në përkthim, duke ndërlidhur përkthimin me lëndë të tjera dhe me Studimet Kulturore.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të trajtojë në mënyrë praktike dhe teorike dukuritë gjuhësore (gramatikore, leksikore, stilistike) të anglishtes dhe shqipes në përkthim.
2. Të zhvillojë aftësitë personale dhe ndërpersonale të studentëve në përkthimin e teksteve të zhanreve dhe stileve funksionale të ndryshme.
3. Të pajisë studentët me teknika dhe strategji për zgjidhjen e problemeve gjatë përkthimit të teksteve të ndërlikuara dhe të niveleve të ndryshme të vështirësisë.

Rezultatet e pritshme: Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë të aftë të:

1. Kuptojnë dhe aplikojnë në mënyrë të vetëdijshme rolin e përkthimit në procesin e komunikimit dhe në mësimdhënie/nxënie të gjuhës.
2. Përdorin dhe manipulojnë me efikasitet tekstet e stileve funksionale të ndryshme (sidomos të medias) në të dyja gjuhët – anglisht dhe shqip.
3. Zbatojnë teknika për të identifikuar dhe zgjidhur probleme përkthimore, në përputhje me teoritë dhe praktikën përkatëse.
4. Integrojnë njohuritë gjuhësore, stilistike dhe kulturore në përkthimin praktik të teksteve të zhanreve të ndryshme.